

# Buletini Mjedisor

## MINISTRIA E MJEDISIT – PO PUNOHET PËR STANDARTIZIMIN E TË DHËNAVE MJEDISORE



Një nga objektivat kryesore

të punës së Ministrisë së Mjedisit, është përmirësimi i procesit të monitorimit të elementëve, që tregojnë cilësinë e mjedisit në Republikën e Shqipërisë.

Me fillimin e punës së Qeverisë së re, një nga reformat e para të Ministrit Lefter Koka, ishte ndryshimi i statusit të Agjencisë së Mjedisit në një Agjensi Kombëtare të Mjedisit.

Ky ndryshim u reflektua në një përmirësim të ndjeshëm si në infrastrukturën e kësaj Agjencie, por dhe në pajisjet laboratorike që mundësojnë standartizimin e elementëve që monitorohen.

Nga laboratoritë e kësaj agjencie vijon puna për të arritur standartet e kërkuara nga Bashkimi Europian.

Reflektim i këtyre ndryshimeve

ishte monitorimi dhe raportimi i të dhënave të monitoruara për ujërat sipërfaqësore në Shqipëri për vitin 2013, vlerësuar kjo dhe nga Agjencia Europiane e Mjedisit.

Në vazhdimësi të përmirësimit të vazhdueshëm të këtij procesi si dhe digitalizimit të të dhënave mjedisore, Agjencia e Mjedisit gjatë muajit shtator mundësoi **hartën topografike të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore në Shqipëri**.

Në këtë hartë janë përfshirë të dhëna mjedisore statistikore mbështetur në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2013. Këto të dhëna mjedisore janë mbledhur nga stacionet e monitorimit të ujërave bregdetare larës, ujërave të liqeneve dhe të lumenjve.

Shpjeguesi i hartës bën të mundur leximin e të dhënave

mjedisore dhe topografike. Ngjyrat janë përshtatur sipas Direktivës Europiane të Ujit.

Gjithashtu po punohet për të përmirësuar të dhënat reale mbi pyjet shqiptar. Shumë shpejt do të fillojë puna për krijimin e **Kadastre të Pyjeve Elektronike** dhe do të realizohet inventarizimi i pyjeve dhe i kullotave në Republikën e Shqipërisë. Ky element do jetë një komponent i projektit që do fillojë së shpejti i Shërbimeve Mjedisore. që do zbatohet nga Ministria e Mjedisit, i financuar nga Fondi Global i Zhvillimit, Fondi i Mirëbesimit Suedez (SIDA) dhe Banka Botërore.

Me realizimin e kësaj kadastre elektornike do të ndihmohen të gjithë vendimmarrësit e sektorit të pyjeve, të cilat me të dhënat e përfituara do të mund të ndërtojnë politika të qarta dhe të zbatueshme për përmirësimin e situatës së pyjeve në vend.

## 22 SHTATORI “NË QYTET PA MAKINËN TIME”



U bënë 12 vjet që Shqipëria është pjesë e inisiativës

Europiane në “Në qytet pa makinën time”.

Kjo inisiativë është pjesë e Javës Europiane të Lëvizshmërisë, e cila fillon çdo 16 Shtator dhe kulmon me aktivitete në datën 22 Shtator të çdo viti.

22 shtatori i këtij viti, u mendua ndryshe, nga Ministria e Mjedisit. Kjo ditë filloi me një emision në orët e mëngjesit, ku Ministri i Mjedisit, zoti Lefter Koka ju bëri thirrje qytetarëve të ndërgjegjësoheshin për të përdorur mjetet e transportit miqësore me mjedisin. Gjatë kësaj dite dy zëvendësministri dhe drejtorët e Përgjithshëm të Mjedisit zhvilluan orë të hapura me nxënësit e disa shkollave të

Tiranës. Forma e edukimit mjedisor u zgjodh, si një formë e qëndrueshme për të edukuar brezin e ri për të përzgjedhur një alternativë ndryshe sjelljeje me mjedisin.

Që nga viti 2002 Ministria e Mjedisit në mënyrë të vazhduar ka inkurajuar, por dhe tërhequr vëmendjen e pushtetit lokal, për të ndërmarrë politika lehtësuese për të gjithë qytetarët, që duan të përdorin mjetet miqësore me mjedisin.

Aktualisht situata sidomos në qytetet e mëdha lë ende për të dëshiruar. Ndryshe ka ndodhur me Pushtetin Qëndror, i cili ka mundësuar në këtë vit të inkurajoj futjen e disa shërbimeve për qytetarët ku përdorin mjete miqësore me mjedisin.

Ekspierenca të shkëputura por

mjaft positive. Do sillnim këtu shërbimin që Posta Shqiptare ka sjellë për klientët e saj. Shërbimin postar me biçikleta, ku punonjësit e postës për distanca të afërta përdorin si mjet transportbiçikletën, gjë që përmirëson shpejtësinë e shërbimit me një kosto të ulët, por dhe ndihmon për përmirësimin e cilësisë së ajrit për qytetin e Tiranës, një qytet që njihet për trafikun e rënduar.

Shërbim tjetër për të përmendur ka qënë ruajtja e qetësisë gjatë muajve të plazhit nga Policia e Shtetit, të cilët patrullonin me biçikleta gjatë bregdetit. Edhe ky shërbim, i cili përdorte biçikletat si mjet transporti, qe një risi për realitetin shqiptar.



## LEJET MJEDISORE GUSHT 2014

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	Angelo Shoes	Përpunim lëkure	Korçë	VNM-Paraprake
	Bankers Petrolum	Rrëzë bituminoze, shtrim rrugësh,		
2	Albania LTD	vendgrumbullim	Fier	VNM-Paraprake
3	Guri Bani	Furrë gëlqere	Fier	VNM-Paraprake
4	Komuna Ulëz	Ndërtim ujës-jellësi	Ulëz, Dibër	VNM-Paraprake
5	Ikona	Impiant riciklimi	Lushnje	VNM-Paraprake
6	Claudio Group	Prodhim pellet	Kavajë	VNM-Paraprake
7	Vito Konomi	Ndërtim magazine	Vorë, Tiranë	VNM-Paraprake
8	Edil Al It	Kompleks banimi	Tiranë	VNM-Paraprake

## LEJET MJEDISORE SHTATOR 2014

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
	TREMA		Moglicë,	
1	ENGINEERING 2	Asfalto-beton	Korçë	VNM-Paraprake
	"ARTEMIS FARM"	Rritje derrash	Vaqarr, Tiranë	
2				VNM-Paraprake
	"ARTEMIS FARM"	Prodhim ushqimi për kafshë	Vaqarr, Tiranë	
3	KOMUNA QENDER	Ripozicionim kanali		VNM-Paraprake
4	LIBRAZHD	vadites	Librazhd	VNM-Paraprake
	FONDI I ZHVILLIMIT	Rehabilitim aksi	Kashar,	
5	SHQIPTAR	rrugor	Tiranë	VNM-Paraprake
	EVI CONSTRUKTION &			
6	EVI	Shfrytëzim kromi	Bytyc, Kukës	VNM-Thelluar
	TRADE MINERALS		Gjegjan,	
7	AL	Shfrytëzim bakri	Kukës	VNM-Thelluar
	FONDI I ZHVILLIMIT			
8	SHQIPTAR	Lungo Mare	Vlorë	VNM-Thelluar
		Magazina	Ahmetaq,	
9	REXHEP RRAJA	frigoriferike	Tiranë	VNM-Paraprake
			Proptisht,	
10	CHANCE	Shfrytëzim kromi	Pogradec	VNM-Paraprake

## LEJET MJEDISORE SHTATOR 2014

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	Kadria	Godinë 3 kate universitare	Rr. "D. Hoxha", Tiranë	VNM-Paraprake
2	MARGIS-Italia	Vila pushimi	Tale, Lezhë	Refuzim
3	MARGIS-Italia	Vila pushimi	Tale, Lezhë	Refuzim
4	MARGIS-Italia	Vila pushimi	Tale, Lezhë	Refuzim
5	MARGIS-Italia	Vila pushimi	Tale, Lezhë	Refuzim
6	MARGIS-Italia	Vila pushimi	Tale, Lezhë	Refuzim
7	MARGIS-Italia	Vila pushimi	Tale, Lezhë	Refuzim
8	MARGIS-Italia	Vila pushimi	Tale, Lezhë	Refuzim
9	MARGIS-Italia	Vila pushimi	Tale, Lezhë	Refuzim
10	MARGIS-Italia	Vila pushimi	Tale, Lezhë	Refuzim
11	MARGIS-Italia	Vila pushimi	Tale, Lezhë	Refuzim
12	Fushe-Kruje Cement Factory	Shfrytëzim guri gëlqerorë	Fushë-Krujë, Durrës	Deklaratë Mjedisore
13	"RO - AL"	Kapanon industrial	Kashar, Tiranë	VNM-Paraprake
14	ITALY AGROFOOD	Magazinë ushqimore	Spitalle, Durrës	VNM-Paraprake
15	Bashkia Mamurras	Sistemim rrjeti,	Mamurras, Laç	VNM-Paraprake
16	Evi konstruktion & evi- mineral invest	Shfrytëzim i mineralit krom	Bytyç, Kukës	Deklaratë Mjedisore
17	Trade Minerals AL	Shfrytëzim bakri	Gjegjan, Kukës	Deklaratë Mjedisore

### VIJON PUNA ME PROJEKTET REHABILITUESE TË MJEDISIT



Ministria e Mjedisit ka ndërr-marrë një sërë projektësh për të ndryshuar pamjen e disa shtretërve të lumenjve si dhe segmenteve hyrëse të rrugëve nacionale. Në kuadër të këtyre projekteve, ditën e martë, datë 30 Shtator 2014, Ministri i Mjedisit së bashku me Kryeministrin e vendit, z. Edi Rama, deputeten e këtij qyteti znj. Monika Kryemadhi dhe kryetarin e bashkisë së Lezhës, z. Viktor Tushaj u inspektuan kryerjet e punimeve për transformimin e bregut të Drinit, pjesë e qytetit të Lezhës. Ky

projekt ka si objekt të punës transformimin e zonën së bregut të Drinit, ku do të mbillen 1000 pemë të llojit rrap, 2500 shkurre dekorative si dhe do kryen punime për krijimin e një pedonale prej 2 km. Gjithashtu përgjatë bregut të rehabilituar të Drinit do të vendosen 50 stola për relaksimin e qytetarëve.

Aktualisht kjo dhe zonë është tërësisht e degraduar dhe e mbuluar nga mbeturinat e derdhura në shtratit e lumit.


Në përfundim të projektit, kjo pjesë e qytetit, do të shndërrohet në një zonë të bukur kreative



për qytetarët e Lezhës.

Ky projekt ishte në vazhdimësi të projekteve rehabilituese të ndërrmarra nga Ministria e Mjedisit. Deri tani ka përfunduar rehabilitimi i segmentit nga aeroporti "Nënë Tereza" deri në Kashar. Në këtë segment u mbollën rreth 25000 pemë të llojit, bli, kumbull e kuqe, rrap e frashër;

Janë në vazhdim punimet për gjelbërimin e Kodra Vile, Durrës; Parkun Kombëtar të Lurës dhe Parkun Kombëtar të Kune Vain.



## THËNIA E MUAJIT

“Koha më e mirë për të mbjellë një pemë: ka qënë 20 vite më parë, koha e dytë më e mirë është të mbjellësh tani.”

*Shprehje Afrikane*

SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT

Email: [info@moe.gov.al](mailto:info@moe.gov.al)

## NGA AKTIVITETET E MINISTRISË SË MJEDISIT



**P**rezantohet rishikimi dhe Përditësimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Konventën e Stokholmit, mbi Ndotësit Organik të Qëndrueshëm (NOQ) në Shqipëri”.

Në takimin e organizuar nga Ministria e Mjedisit morën pjesë përfaqësues nga Ministrinë e Linjës, përgjegjës për menaxhimin e kimikateve në faza të ndryshme të ciklit të tyre të jetës, përfaqësues të Universitetit të Tiranës dhe atij Bujqësor si dhe përfaqësues nga organizatat joqeveritare mjedisore.

Projekti vjen në kuadër të marrëveshjes së përbashkët, firmosur midis ministrit të Mjedisit Z. Lefter Koka dhe UNEP-GEF, në qershor të këtij viti. Projekti gjatë dy viteve në vazhdim do të asistojë vendin tonë në rishikimin dhe përditësimin e Planit Kombëtar ekzistues të Veprimit për NOQ, hartuar dhe miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, në vitin 2006; Forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional si në nivel

qëndror, lokal dhe atë ndërkombëtar, për fushën e administrimit të kimikateve në përgjithësi dhe NOQ në veçanti; si dhe në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe teknike, që lidhen me monitorimin, kontrollin dhe reduktimin e shkarkimeve në mjedis të këtyre substancave kimike.

Nëpërmjet zbatimit të këtij projekti do të përmbushen kërkesat dhe objektivat që rrjedhin nga Konventa e Stokholmit “Për Ndotësit Organik të Qëndrueshëm”, dhe i Protokollit që trajton 23 ndotes kimik te klasifikuar si NOQ, në aspektin e Ndotjes së ajrit në kontekst ndërkufitar, ku 11 NOQ trajtohen për herë të parë.

Konventa e Stokholmit “Për Ndotësit Organik të Qëndrueshëm”, është nënshkruar nga Shqipëria më 5 dhjetor 2001 dhe është ratifikuar më 4 tetor 2004. Ajo synon kontrollin, reduktimin dhe eliminimin e shkarkimeve të NOQ në mjedis.

**K**a filluar procesi i ri draftimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin për periudhën 2014-2020. Hartimi i këtij dokumenti të rëndësishëm në fushën e larmisë biologjike i është besuar kompanisë konsulente “Instituti Kërkimor Barleti” në partneritet me “DIAVA Consulting”. Ky partneritet po vijon bashkëpunimin

e saj me ekspertë të fushës së natyrës dhe biodiversitetit nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës si dhe me ekspertët që janë pjesë e Drejtorisë së Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura në Ministrinë e Mjedisit.

Në takimin konsultativ që u zhvillua ditën e enjte, datë 25 Shtator 2014, në Ministrinë e Mjedisit, u prezantua objektivat dhe disa nga fushat e veprimit, që janë përcaktuar nga ekspertët që po draftojnë këtë strategji të re.

Të ftuarit në këtë takim ishin grupet e ndryshme të interesit, gjithashtu ishin dhe përfaqësues nga Ministrinë e Linjës, ekspertë të fushës nga Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Bujqësor si dhe shoqërisë civile.

Disa nga objektivat e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin janë: që deri në vitin 2020, të sigurohet përafrimi dhe zbatimi i plotë i acquis të BE-së për fushën e mbrojtjes së natyrës; deri në 2015, të ketë një dokument strategjik për biodiversitetin (SPVB) të rishikuar dhe të miratuar – në përputhje me Aichi target 12; deri në 2020; 17 % e territorit tokësor dhe ujërave të brendshme dhe 5-6 % e sipërfaqes detare të jetë shpallur zona e mbrojtur; të rehabilitohen të paktën 15 % e zonave të degraduara nëpërmjet ruajtjes dhe aktiviteteve rehabilituese për këto zona.